

Mënyra e citimit në revistën Studime Historike

Referencat do të vendosen në fund të faqes.

I. Si referohen librat, artikujt e revistave, aktet e konferencave:

- a) Kur referojmë **për herë të parë** një libër, duhet të shkruajmë emrin e plotë dhe mbiemrin e autorit ose të autorëve; mandej, ndarë me presje, vendoset titulli i librit me germa italike, numri i vëllimit nëse vepra është me dy ose më shumë vëllime, vendi i botimit, pas të cilit vendosen dy pika dhe vazhdohet me emrin e shtëpisë botuese, vitin e botimit dhe në fund numrin e faqes. Shembull: **Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, vëll.I, Tiranë: Naim Frashëri, 1984, f. 3.*** Në rast se libri ka njohur më shumë se një botim dhe ne i referohemi p.sh. botimit të dytë të veprës, ky duhet të evidentohet pas titullit: **Georg Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte, 2. Auflage, Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1966, S. 12.***
Pas referimit të parë, vepra duhet referuar në formë të shkurtuar, formë e **cila duhet paralajmëruar** qysh në referimin e parë të plotë të veprës. Në formën e shkurtuar jepet vetëm gërma e parë e emrit të autorit, e ndarë me pikë nga mbiemri që jepet i plotë, më tej një variant orientues i shkurtuar i titullit të veprës, numri i vëllimit në shifra romake, e në fund numri i faqes së referuar. Shembull: **S. Pulaha, *Popullsia e Kosovës, I, 3; G. Stadtmüller, *Forschungen, 12.****
- b) Kur bëhet fjalë për referimin e një vepre të përkthyer nga një gjuhë e huaj, pas emrit të autorit **sipas grafisë së gjuhës së huaj**, vendoset në italike titulli shqip i veprës, pastaj emri i përkthyesit, vendi dhe emri i shtëpisë botuese shqiptare, viti i botimit shqip e, në fund, numri i faqes. Shembull: **Noel Malcolm, *Agjentë Perandorakë. Një familje shqiptare në botën mesdhetare të shek. XVI, përktheu Kastriot Myftiu, Tiranë: Dudaj, 2016, f. 37 (= N. Malcolm, *Agjentë perandorakë, 37).****
- c) Një artikull reviste shkencore në formën e plotë, d.m.th. për herë të parë, referohet: emri i plotë i autorit, në thonjëza vijon titulli i artikullit, me gërma italike vijon emri i revistës, pastaj vijohet normalisht me numrin e revistës, vendin e botimit, vitin e botimit e numrin e faqes. Shembull: **Pranvera Dibra, “Marrëdhëniet diplomatike konsullore Shqipëri-Austri 1922-1992”, *Studime Historike, nr. 1-2, Tiranë: 2014, f. 37.***
Në formën e shkurtuar do kemi: **P. Dibra, “Marrëdhëniet diplomatike konsullore...”, 37.** Pra, nga titulli i artikullit, kur ky është i gjatë, do jepen vetëm 3-4 elementët e parë, të ndjekur nga tre pika.
- d) Për revistat e njohura të huaja, që botohen një herë në vit dhe që e kanë ruajtur periodicitetin, pas emrit të plotë të autorit e titullit të artikullit brenda thonjëzave, vihet në italike emri i revistës, pastaj normalisht vijohet me renditjen sipas vjetëve (vëllimit) të revistës, në kllapa viti i

botimit, e në fund numri i faqes, psh.: **Peter Schreiner**, “*Der Dux von Dalmatien und die Belagerung von Anconas im Jahre 1173*”, *Byzantion* 41 (1971) 125. Në variantin e shkurtuar i njëjti artikull do të jepej: **P. Schreiner**, “*Der Dux von Dalmatien...*”, 125.

Kur revista del më shumë se një herë në vit, pas numrit=volumit të revistës vendoset numri vjetor (i fashikullit), psh.: **Titos P. Jochalas**, “*Considerazioni sull’onomastica e toponomastica albanese in Grecia*”, *Balkan Studies*, vol. 17, nr. 2, Tessaloniki, 1976, p. 317 (=T. Jochalas, “*Considerazioni sull’onomastica...*”, 317).

- e) Për kontribute të përfshira në akte konferencash, mënyra e referimit do jetë: Emri i plotë e mbiemri i autorit, në thonjëza titulli i artikullit, vijohet me italice me titullin e konferencës, vendin e datën e zhvillimit të saj, me emrin apo emrat e përgatitësve të vëllimit, me vendin e botimit dhe, ndarë me dy pika, me emrin e entit botues, më tej me vitin e botimit e numrin e faqes. Shëmbull: **Sima Ćirković**, “*Tradition interchanged: Albanians in the serbian, Serbs in the albanian late medieval texts*”, në: *The Mediaeval Albanians, International Symposium, Athens 3-5 May 1996*, Ed. Charalambos Gasparis, Athens: Institute for Byzantine Research, 1998, p. 197 (= S. Ćirković, “*Tradition interchanged...*”, 197). Tjetër shëmbull: **Aleks Buda**, “*Gjergj Kastriot-Skënderbeu dhe epoka e tij*”, në: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Tiranë 12-18 janar 1968, vëll. I, Tiranë: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1969, f. 75. (=A. Buda, “Gjergj Kastrioti...”, 75).*
- f) Për kontributet në botime me rastin e përvjetorëve të studjuesve të shquar (Festschrift) procedohet: emri e mbiemri i plotë i autorit, titulli i kontributit mes thonjzash, përcaktimi i rastit të atij botimi me g[rma italice, emri i përgatitësit apo përgatitësve të botimit, vendi i botimit, enti botues, viti i botimit e nr, faqes. Shëmbull: **Luan Malltezi**, “*Një dokument i ri mbi Skënderbeun*”, në: *In memoriam Aleks Buda, në 100 vjetorin e lindjes*, përg. Muzafer Korkuti, Jorgo Bulo, Emin Riza, Tiranë: Akademia e Shkencave, 2010, f. 34. (=L. Malltezi, “*Një dokument i ri...*”, 34). Shëmbull tjetër: **Pëllumb Xhufi**, “*Rebelles et unionistes dans les Balkans ottomans: l’insurrection d’Epire de 1611*”, in: *Byzance et ses périphéries. Hommage à Alain Ducellier*, përg. Bernard Doumerc et Christophe Picard, Toulouse: Université Le Mirail, 2004, p. 323. (=P. Xhufi, “*Rebelles et unionistes...*”, 323).
- g) Kur përsëritet referimi pararendës, shkruhet në italice: *Po aty*, f. 32.
- h) Për të cituar fraza apo paragrafë të një autori, përdoren thonjëzat. Nëse fjalët ose frazat janë kapërcyer duhen zëvendësuar me tri pika (...). Nëse fjalët e shtuara nuk janë në tekstin origjinal, pra, janë shtuar nga autori, ato duhen vendosur në kllapa katrore []. Citimi i tekstit duhet bërë si në origjinal. Nëse ka gabim në tekstin origjinal, djathtas në parantezë vendoset fjala latine “*sic*”, në kuptimin që citimi pasqyron besnikërisht tekstin origjinal, ndaj përgjegjësia është e autorit të tij. Në rastet kur në

citime bëhen nënvizime nga autori, në kllapa vendoset shënimi: (nënvizimi i aut.).

- i) Shënimet sqaruese, komentuese bëhen me yje progresive për çdo faqe.

II. Referimet sipas arkivave:

Për t'iu referuar arkivave shqiptare duhet:

- a) Kur citohet për herë të parë, emri i arkivit shkruhet i plotë, dhe mes kllapash vendoset shkurtimi i tij me germa italiane. Më tej vazhdohet me emrin e fondit përkatës, vitin, numrin e dosjes e mandej të fletës. Vijohet me dërguesin, marrësin e dokumentit, dhe me datën. Shembull: **Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi: KQ i PPSH, viti 1987, dosja 2, fleta 33. Leter e Foto Çamit drejtuar Ministrit të Jashtëm Reis Malile, Tiranë, 21 qershor 1987.** Në citimet e mëvonshme, zërat: fondi, dosja, fleta jepen në formë të shkurtuar, pra i njëjti dokument do citohej: **AQSh, F. KQ i PPSH, V. 1987, D. 2, fl. 33. Leter e Foto Çamit drejtuar Ministrit të Jashtëm Reis Malile, Tiranë, 21 qershor 1987.** Shembull tjetër: **Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti 1934, dosja 255, fleta 166. Lec Kurti për Ministrin e Jashtëm Xhafer Vila, 7 prill 1934.** I njëjti dokument, në vijim do citohej me shkurtime të kursyera: **AMPJ, V. 1934, D. 255, fl. 166. Lec Kurti për Ministrin e Jashtëm Xhafer Vila, 7 prill 1934.**
- b) Për citimin e Arkivave të huaja, do kihet parasysh se libri do i drejtohet lexuesit të huaj të kualifikuar duke u botuar në gjuhën angleze. Prandaj, në citimin e dokumenteve arkivore të huaja, do t'i qëndrohet gjuhës dhe kritereve të vendit përkatës. Shëmbull, citimi i parë i plotë: **The National Archives (më tej: TNA), Public Record Office, Foreign Office 371/18339. Sir R. Hodgson to Sir John Simon, Durrës, 24 January 1934.** Citimi i mëtejshëm i shkurtuar: **TNA, FO 371/18339. Sir R. Hodgson to Sir John Simon, Durrës, 24 January 1934.** Tjetër shembull: citim i parë i plotë: **Archivio di stato di Venezia (më tej: ASVe), Capo Consiglio dei Dieci, Lettere di Ambasciatori, Rettori e di altre cariche: Corfù, busta 291 (a. 1500-1559). Relazione del bailò Zuanne da Cà de Pesaro, 9 maggio 1547.** Në vijim, i njëjti dokument do citohet: **ASVe, CCX, Lettere Rettori: Corfù (a. 1500-1559): Relazione del bailò Zuanne da Cà de Pesaro, 9 maggio 1547.**

III. Referimet sipas përmbledhjeve dokumentare.

- a) Rasti i parë: Vëllime dokumentare, që kanë paraqitur vështirësi specifike për mbledhësin (mbledhësit) e botuesin (botuesit) e tyre, d.m.th. përmbajnë dokumente në gjuhë të rralla (greqishte e vjetër, latinisht, sllavishte e vjetër, osmanisht), që ekzistojnë në formë dorëshkrimi, gjë që presupozon njohuri të thella në paleografinë e diplomatikën e atyre gjuhëve për transkriptimin e dokumenteve në fjalë, të cilave vështirësi u shtohet edhe përkthimi i tyre në gjuhët moderne. Për vëllime të tilla

dokumentare, që i përkasin kryesisht periudhës së Antikitetit, të Mesjetës e të Epokës Moderne (shek. XVI-XVIII), në fillim duhet të vihet i plotë emri i mbledhësit (mbledhësve) e botuesit (botuesve) të vëllimit. Shembull citimi i plotë: **Theodore Mommsen, Wilhelm Henzen, *Corpus Inscriptionum Latinarum*, vol. I, Berlin: Georg Reimer, 1863, f. 32.** Citimi i shkurtuar: **Th. Mommsen-W. Henzen, *CIL*, II, 32.** Tjetër shëmbull: **Skënder Anamali, Hasan Ceka, Élizabeth Deniaux, *Corpus des Inscriptions Latines d'Albanie*, Collection de l'École Française de Rome-410, Rome: École française, 2009, nr. 118, f. 102 (=S. Anamali, H. Ceka, É. Deniaux, *Corpus des Inscriptions Latines d'Albanie*, nr. 118, f. 102).**

Të njëjtit rregull do i përmbahet citimi i enciklopedisë klasike të Antikitetit: **August Friedrich Pauly, Georg Wissowa, *Realencyclopädie der classischen Alterthumwissenschaft*, I. Band, Reihe 1 (Aal-Alexandros), Stuttgart: J. B. Metzler, 1893, S. 353.** Në formë të shkurtuar: **Pauly-Wissowa, *Realencyclopädie*, I/1, 353.** Tjetër shëmbull: **Ludwig Thalloczy, Constantin Jireček, Milan Šufflay, *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, vol. I, Vindobonae: Adolph Holzhausen, 1913, nr. 49 (=L. Thalloczy, C. Jireček, M. Šufflay, *Acta Albaniae*, I, 49).**

Gjithashtu: **Franz Miklosich, Joseph Müller, *Acta et Diplomata Graeca Medii Aevi Sacra et Profana*, vol. I, Vindobonae: Karl Gerold, 1860, S. 34 (=F. Miklosich-J. Müller, *Acta Graeca*, I, 34).** Gjithashtu: **Injac Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. III (1603-1621), Tiranë: Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, 1989, nr. 57, f. 123 (=I. Zamputi, *Dokumente shek. XVI-XVII*, III, nr. 57, f. 123).** Dhe në fund: **Halil İnalçik, *Hicri 835 Tarihli Sûret-î Defter-î Sancak-î Arvanid*, Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954, f. 29 (=H. İnalçik, *Sancak-î Arvanid*, 29).**

- b) Rasti i dytë, që lidhet me botimet dokumentare për periudhat e historisë së re e bashkëkohore: fillimisht vihet titulli i botimit, pastaj numri i serisë (nëse ekziston) e numri i vëllimit, vijon emri i përgatitësit të vëllimit në fjalë, vendi i botimit, shtëpia botuese e numri i faqes. Shëmbull: ***Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: DDI), serie IX, vol. 10, a cura di Marco Pinzaglia, Roma: Tipografia di Stato, 1993, p. 37 (=DDI, serie IX, vol. 10, 37).** Tjetër shëmbull: ***Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirimin Kombëtar, 1918-1920*, vëll. I, përg. Muin Çami, Tiranë: Instituti i Historisë, 1975, f. 263 (=Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirimin Kombëtar, I, 263).**